

**MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AGJENCINË E MJEDISIT DHE PYJEVE, TIRANË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, me objekt “Për organizimin, drejtimin dhe zbatimin e programit vjetor të monitorimit të mjedisit” për periudhën 10.10.2009 deri më 31.12.2011., dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 85 datë 07.06.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 180/5, datë 07.06.2012, dërguar [REDAKTUAR] Kryetar i Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, Tiranë, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, të pasqyrojë në mënyrë të hollësishme si dhe të bëjë ndryshime dhe plotësime në Rregulloren e Brendshme për organizimin dhe veprimtarinë e agjencisë duke reflektuar dhe pasqyruar përgjegjësitë dhe detyrimet që rrjedhin për këtë agjenci edhe nga legjislacioni i ri mjedisor, trajtuar në faqet 10 - 13 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

2. AMP të hartojë dhe aprovojë në kohë programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit me qëllim që në datën 1 Janar të vitit pasardhës të fillojë zbatimin dhe monitorimi i tij, trajtuar në faqet 13- 19 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë dhe në vazhdim

3. AMP të bashkëpunojë me organet qendrore dhe institucionet monitoruese të ngarkuara për zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit me qëllim sigurimin dhe dorëzimin brenda afateve të përcaktuara në agjenci të të dhënave mbi treguesit mjedisorë, trajtuar në faqet 13-19 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

4. AMP të bashkëpunojë me MMPAU për hartimin dhe miratimin e standardeve që do të shërbejnë për hartimin e teknologjive të pastra si dhe futjen e sistemeve të administrimit mjedisor, trajtuar në faqet 28 - 31 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

5. Raporti për Gjendjen e Mjedisit i hartuar nga AKM, duhet të ketë në përmbajtje një analizë të mirëfilltë të treguesve mjedisorë, ku të specifikohen shkaktarët e ndotjes dhe problematikat apo impakti që këta ndotës shkaktojnë për mjedisin dhe popullsinë në periudhën aktuale por edhe në vitet e ardhshme. Rezultatet dhe konkluzionet e të dhënave të krahasohen me ato të një viti më parë apo të dhjetëvjeçarit të fundit për të nxjerrë në pah përkeqësimin apo përmirësimin e treguesve mjedisorë dhe gjendjes së mjedisit në tërësi për një periudhë të caktuar kohore, trajtuar në faqet 19 - 24 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

6. AMP të pasqyrojë në regjistrat përkatës të dhënat e mjedisit dhe të krijojë bazën elektronike të të dhënave të mjedisit, trajtuar në faqet 19 - 24 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

7. AMP të rrisë mbështetjen teknike dhe dhënien e këshillimeve për MMPAU e cila ka rezultuar në nivel të ulët, trajtuar në faqet 25 - 28 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

8. AMP të hartojë programe pune për ndjekjen dhe realizimin e kontratave nëpërmjet verifikimit të vërtetësisë dhe cilësisë së analizave e të dhënave që vijnë nga institucionet duke caktuar specialistë të fushave përkatëse, trajtuar në faqet 31 - 34 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

9. AMP të publikojë të dhëna për mjedisin në mënyrë që të plotësojë kërkesat e publikut për informacionet mjedisore, në zbatim të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002, i ndryshuar, neni 69, pika 2 gërma 'ë', trajtuar në faqet 19 - 24 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

10. Të njoftohet kontraktori Altelekom, për mbylljen e shërbimit të telefonisë fikse për bisedat ndërkombëtare, si shërbim i panevojshëm, referuar praktikave të deritashme, në marrëdhëniet me organizmat e huaja, trajtuar në faqet 37 - 47 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

11. AMP dhe MMPAU në hartimin e kontratave të monitorimit të treguesve mjedisorë, të përcaktojnë sanksione për vonesat ose për moszbatimin e detyrimeve nga palët, në zbatim të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të monitorimit të Mjedisit", trajtuar në faqet 19 - 24 dhe 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

12. AMP dhe MMPAU në hartimin e kontratave të monitorimit të bëjnë ndryshimet lidhur me koordinimin e afatit kohor të kryerjes së monitorimit, paraqitjes së dokumentacionit justifikues financiar e teknik me afatin dhe mënyrën e kryerjes së pagesave, pasi volumi i punës dhe shpenzimet e kryera në përputhje me buxhetin e miratuar, nuk janë shoqëruar me kopje të dokumentacionit financiar me vulë thesari brenda afateve kohore të përcaktuara në kontratë, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

13. AMP dhe MMPAU, të programojnë, dokumentojnë e pasqyrojnë mënyrën e llogaritjes për të gjitha zërat e shpenzimeve, të detajuara për çdo monitorim të kryer nga institucionet, pasi rezulton se këto shpenzime janë jashtë kontrollit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

14. AMP dhe MMPAU në hartimin e kontratave të monitorimit të treguesve mjedisorë, të përcaktojnë detyrat përkatëse për monitorimin e kontratave dhe kontrollin e shpenzimeve të kryera nga institucionet monitoruese, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

- Për Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave

1. MMPAU të hartojë dhe miratojë udhëzimin në lidhje me rregullat për krijimin, administrimin dhe përditësimin e kadastrës mjedisore dhe të kërkojë nga AKM ngritjen e kadastrës së mjedisit në nivel kombëtar, trajtuar në faqet 34 - 37 të Raportit të Auditimit.

Deri në dhjetor 2012

2. MMPAU t'i propozojë për miratim Këshillit të Ministrave, rregullat mbi organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve, strukturën organizative, organikën si dhe marrëdhëniet me institucionet e tjera, trajtuar në faqet 9 - 10 të Raportit të Auditimit.

Deri në dhjetor 2012

3. MMPAU, të përcaktojë procedurat dhe afatet kohore për hartimin, miratimin dhe publikimin e Raportit mbi Gjendjen e Mjedisit në Shqipëri. Botimi dhe publikimi i të dhënave me vonesë e humbet rëndësinë dhe aktualitetin e informacionit që përmban raporti si dhe i bën të pazbatueshme rekomandimet e lëna subjekteve për përmirësimin e situatës mjedisore, trajtuar në faqet 13 - 19 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

4. MMPAU, të përcaktojë qartë treguesit e dukurive natyrore dhe të cilësisë së mjedisit të cilat do të monitorohen nga institucionet përkatëse, me shpenzimet e buxhetit të shtetit duke lidhur me ta kontrata, në bazë të procedurave të konkurrimit, trajtuar në faqet 13 - 19 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në nenin IX "Pagesat" të kontratave të nënshkruara me institucionet për monitorimin e treguesve mjedisorë të merren masa nga Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve, në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit në Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, për arkëtimin e shumës prej **2,062,525 lekë**, nga këto institucione për vitet 2010 - 2011, si më poshtë:

1. Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **330,580 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR] duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

2. Të kërkohe në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **360,000 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

3. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **340,640 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

4. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **8,910 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

5. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **59,690 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

6. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **2,789 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

7. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **24,884 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

8. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **428,712 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

9. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **4,648 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

10. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **71,354 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

11. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **157,770 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDACTED], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

12. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **15,000 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

13. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **70,000 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

14. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **11,248 lekë**, përfituar padrejtësisht nga [REDAKTUAR], duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 47 - 63 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

15. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **207,078 lekë**, përfituar padrejtësisht nga zj. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtoresë e AMP-së, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 37 - 47 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

16. Të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik me vlerë **458,379 lekë**, përfituar padrejtësisht nga:

- zj. [REDAKTUAR], Drejtoresë AMP. në vlerën **425,686 lekë**;

- z. [REDAKTUAR], Përgjegjës i Laboratorit Pogradec, në vlerën **1,577 lekë**.

- z. [REDAKTUAR], Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, në vlerën **31,116 lekë**, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, trajtuar në faqet 37 - 47 të Raportit të Auditimit.

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

1. Mbështetur në nenin 37, 153 e 154 të ligjit 7961 datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në kontratën kolektive të punës do t’i kërkohet Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës”

Për:

- Zj. [REDAKTUAR], me detyrë Drejtoresë e Agjencisë së Mjedisit dhe Pyjeve;

për arsye se:

- Nuk ka përdorur me efikasitet dhe efektivitet burimet e vëna në dispozicion, pasi produkti i dhënë është në kundërshtim me nenin 69, të ligjit nr. 8934, datë 05.09.2002, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

- Nuk janë plotësuar dhe zbatuar në mënyrë të dukshme kërkesat e VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e programit kombëtar të monitorimit të mjedisit”.

Shih procesverbalet nr. 6, datë 12.03.2012 dhe nr. 9 datë 15.03.2012.

- Në dhënien e urdhrin për kryerje të shpenzimeve në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenet 23 e 28, VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kapitulli VI, Udhëzimi nr. 2, datë 18.02.2008 i APP-së, pika 3 “Për Procedurën e prokurimit me Vlera të Vogla”.

Shih procesverbalet nr. 3, datë 08.03.2012, nr. 4, datë 09.03.2011 dhe nr. 7, datë 13.03.2012.

- Për kundërvajtje administrative në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 4, gërma a dhe ç, si dhe nenin 19, në cilësinë e Titullarit të institucionit, **si nëpunës autorizues**, për keqmenaxhim financiar të buxhetit të AMP-së.

- Për përfitim të pa ligjshëm nga shërbimi i telefonisë celulare, në kundërshtim, me VKM nr. 343 datë 11.07.2002 “**Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë publikë**” dhe shtojcave përkatëse.

Shih procesverbalet nr. 1, datë 16.02.2012 dhe nr. 2 datë 24.02.2012

Meqenëse me shkresën nr. 3676 prot. datë 20.04.2012, është bërë me dijeni Agjencia e Mjedisit dhe Pyjeve si dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, pranë kësaj agjencie, për zbatimin e Urdhrit nr. 186 datë 20.04.2012, të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, me të cilin lirohet nga detyra Zj. Etleva Canaj, masa disiplinore quhet e ezauruar.

Emri i zj. Etleva Canaj, do t'i dërgohet Departamentit të Administratës Publike.

2. Mbështetur në nenin 37, të ligjit 7961 datë 12.07.1995, i ndryshuar, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe në kontratën kolektive të punës Ministrisë së Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore.

“Vërejtje me paralajmërim”

Për:

- **Z. [REDAKTUAR]**, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Analizave dhe Referencave në Agjencinë e Mjedisit dhe Pyjeve, pasi nuk ka zbatuar:

- pikën 1/c, të VKM nr. 1189, datë 18.11.2009 “Për rregullat dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit” Kapitulli III, “Zbatimi i Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit nga organet qendrore dhe institucionet monitoruese”;

- nuk ka hartuar programe pune për ndjekjen dhe realizimin e kontratave nëpërmjet verifikimit të vërtetësisë dhe kontrollit të cilësisë së analizave të kryera për monitorimin e mjedisit për llogari të MMPAU nga institucionet e kontraktuara;

Shih procesverbalin nr. 10, datë 15.03.2012.

3. Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e ndjekura për blerjet me vlera të vogla dhe përgjegjësi individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo blerje, mbështetur në nenin 72 “Kundravajtjet administrative”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 3, Kreu X “Sanksionet administrative dhe masat disiplinore” të VKM nr. 398, datë 26.05.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar propozojmë:

“Vërejtje me paralajmërim”

Për:

1. zj. [REDACTED],
2. zj. [REDACTED];
3. zj. [REDACTED];
4. zj. [REDACTED].

Në cilësinë e anëtarëve të komisionit për blerjet me vlera të vogla:

- Për moszbatim të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Kreu II “Rregullat e përgjithshme të prokurimit” Kufijtë monetarë pikat 1/b e 1/c dhe Kreu VI “Blerja me vlerë të vogël”, në procedurat e ndjekura për “Botimin e Raportit të Gjendjes në Mjedis” për vitet 2010 e 2011 me vlerë 1,348,000 lekë, konkretisht:

-Mungon kërkesa për kryerjen e këtij shërbimi dhe llogaritja e fondit, mungon shqyrtimi i kërkesës nga strukturat e shërbimit të njësisë shpenzuese dhe Komisioni i prokurimit të Blerjeve me vlera të vogla, mungon miratimi i kërkesës nga Nëpunësi Autorizues, mungon kontrata e nënshkruar nga palët për kryerjen e shërbimit, mungon procesverbali për marrjen në dorëzim të mallit nga komisioni, procedura që nga testimi i tregut, marrja e ofertave dhe procesverbali i vlerësimit janë brenda 1 dite si edhe oferta në 1 rast është paraqitur 3 ditë më parë se të dilte urdhri i prokurimit për këtë shërbim. Pra, brenda afatit kohor 2 ditor janë kryer të gjitha procedurat deri në botimin e librit.

-Në urdhrin e prokurimit, në procesverbalet e punës së komisionit, në faturën e shitësit si edhe në fletë hyrjen e magazinës nuk është caktuar sasia e kopjeve, por është shënuar 1 komplet pa përcaktuar sasinë dhe të dhëna të tjera të nevojshme për realizimin e shërbimit.

- Oferta e cila ka kryer shërbimin, është në gjuhën angleze dhe daton më 02.12.2010, ose 3 ditë më parë se të dilte urdhri i prokurimit për kryerjen e këtij shërbimi.

Shih procesverbalin nr. 4, datë 09.03.2012.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit, Agron Maksutaj, Mimoza Bedini, Keida Muça, Mirosh Bogdo më tej u shqyrtua nga k/auditues Mimoza Lloji, Drejtori i Departamentit Athanas Karaja, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT